

BIBLIOTEKA  
SHTETIT

814-32

297

VIKTOR QURKU

*Bijtë  
e nënabe*

TREGIME

814-32

297

VIKTOR QURKU

# BIJTË E NËNAVE

Tregime



2135

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

## V E T E R A N I

Njeriu që po ngjitet në skenë quhet Mark Varfa. Ju them me bindje se atij s'do t'i mbushej mendja lehtë t'ju tregonte për trimëritë e tij në luftë. Mirëpo shokët e kulturës në rreth ia shtruan si detyrë dhe arritën ta shkëpusnin ca ditë, nga fshati. «Jo, — ngulte këmbë Mark Varfa, — s'kam kujt t'ia lë punët e rojës në pyll!»

Vetë fshati i tij s'mbante mend që Mark Varfa të ngrihej ndonjëherë të hidhte fjalë për bëmat e tij. Bëheshin dasma e kuvende, ngjanin lindje e vdekje, e njerëzit kthenin kokën nga luftërat e nga trimëritë, kujtonin e krenoheshin që s'e njihnin frikën e turpin kurrë. Marku ulte kokën i përhumbur në mendime. Kushdo që s'kishte pasur rastin ta njihte nga afër mund të merrte për trim këdo, por s'do t'i shkonte kurrë nëpër mend se një nga ata trima ishte pikërisht ai burrë i shkurtër e thatanik, që rrinte i heshtur, thujse s'merrte vesh se ç'bëhet në këtë botë të madhe.

Inspektori i kulturës në rreth i kishte telefonuar tri herë brenda ditës. Marku nuk ia kishte dhënë fjalën. Herën e dytë inspektori i kishte dhënë të kuptonte se puna e ruajtjes së pyllit natën s'ishte ndonjë arsye që qëndronte. Mark Varfa që nxehur dhe kishte mbyllur telefonin. Pastaj që kthyer në shtëpinë e tij ndanë lumit të bënte

një sy gjumë. Gjithnjë shtrihej disa orë para dite, sepse puna e tij ishte kryesisht natën. Mbështetur te jastëku, dridhte cigare pas cigareje dhe s'i hiqej nga mendja inspektori. Befas vuri re se dhoma ishte pastruar e rregulluar për bukuri dhe ndjeu se mbesa e vogël po i rritej. Mark Varfa e merrte çdo verë në fshat vajzën e djalit që kish-te oficer. Vajza qe mësuar aq shumë me gjyshin, sa harronte se në botë ka prindër që i zë merakun e i merr malli. Marku e merrte atë shpesh në pyll, i tregonte për kafshët e egra të pyllit, e mësonte të ngjitej degëve, e dërgonte burimeve. Kur vinte fundi i verës dhe nga qyteti vinte i ati ta merrte, vajza e vogël me ato dy gërshetat e shkurtra ia plaste të qarit në gjunjë të gjyshit. Mark Varfa i përkëdhelte flokët e i vështronte sytë e lotuar ngjyrë hiri, hundën pakëz të kërcyer dhe i dukej sikur shikonte veten në vogëli. Vajza ikte dhe ai mbetej vetëm gjithë dimrin. E shoqja i kishte vdekur para shumë vjetësh. Vetë ulej e ndizte zjarrin, vetë shkonte për ujë, vetë gatuate dhe vetë priste e përcillte shokë e miq. Dera e tij ishte gjithnjë e hapur. I kishte kaluar të gjashtëdhjetat prej kohësh, por, po të dëgjonte se dikush priste dru në një zonë të ndaluar, ose t'i kapte veshi një krismë të largët, ai shkonte më këmbë me kilometra dhe s'i ndahej kurrë atij që kishte shkelur ligjin. Fajtorët e kishin frikë e mbeteshin të habitur që u dilte papritur nga s'e prisnin. Ai nuk dinte të thërriste e të bërtiste, nuk bënte fjalë e gjyqe. Rojtari i pyllit ishte bindur se në botë s'shkon asgjë mbarë me të thirrura e me të bërtitura.

I vinte keq kur suferina ulërinte mbi drurët e hollë, që sapo kishin çelur, kurorat e luleve të pranverës. «Nga erdhe, moj e mallëkuar, tani!» — thoshte plaku Varfa nën zë. Tundte xhakëtën e vjetër në ajër, sikur donte ta

largonte atë të keqe të papritur të natyrës nga ai pyll, buzë të cilit kishte lindur e ishte rritur. Aty ai gjente djallërinë e hollë e vuajtjet e rënda, luftën e gjakun e shokëve, gëzimin e strehimit partizan e gëzimin e natyrës së gjallë e të përjetshme. Ai vente e vinte nëpër pyll me një dyfek krahëve. Diku ndalej dhe lëmonte me dorë ndonjë trung të goditur nga ndonjë sopatë e egër tinzare. I vinte keq si prej një plage dhe gjer në kasollen e vogël s'i ndahej mendimi për fajtorin.

Në një lëndinë të lartë, nga mund të vëzhgonte gjithë hapësirën, midis kulumbrish të kaltra, kishte thurur një kasolle të vogël. Ndodhte që s'kthehej fare në shtëpi ditën. Mësoheshte kokën nën çurlikimin e zogjve e nën fërfërimën e gjetheve. Dhe ashtu, me kokën në pëllëmbët e gjera, dëgjonte pyllin e madh tejmbanë, si një qenie të gjallë që merr frymë, qetësohet, lëviz e hepohet. Dhe ashtu e zinte një gjumë i lehtë si prej zogu. Lëvizja më e vogël e zgjonte, e ftonte të ngrihej më këmbë. Nuk rronte dot pa pyllin. Djali oficer i lutej shpesh të bashkëjetonin në qytet, po ai i tregonte atij fshatin. Në qoftë se shtetit s'i prishej punë, rruga ishte e hapur që të kthehej edhe ai në fshat, mendonte Marku.

Plaku po dremiste lehtë, kur në dhomën e dytë përdhese të shtëpisë hyri me një frymë mbesa e vogël. Ajo u lëkund njëherë të mos e zgjonte, po plaku hapi sytë.

— Të kërkojnë në telefon, gjysh! — i tha ajo, si e zënë në faj.

— Kush?

— Nga qyteti, më thanë.

Mark Varfa lëvizi njërin krah në shenjë kundërshtimi. Pastaj sikur u pendua dhe u ngrit. «Me siguri inspektori», — tha me vete. Balli iu rruadh. Shkoi duart nëpër

flokët e zbardhuar dhe i tha vajzës së vogël të shkonte të hante drekë, se do të kthehej shpejt.

Ishte palca e vapës, kohë zjarresh të mundshme. Megjithatë ai pranoi të nisej të nesërmen për në qytet. Iu duk e çuditshme që këtë radhë qe bindur aq lehtë. Mbase ngaqë e kishin siguruar se do ta zëvendësonin për gjithë kohën që do të mungonte (qenë marrë vesh me sekretarin e organizatës së Partisë, i thanë).

Kur shkeli në trotuar dhe u gjend mes zhurmës së qytetit, ndali dhe u vrenjt, se kujtoi pyllin. Po sikur ndonjë sopatë tinzare...

— E, mor lanet inspektor, ç'më bëre! — foli nën zë, gati duke psherëtirë dhe u nis ngadalë drejt pallatit të kulturës në qendër të qytetit.

Ja ku është në skenë. Rri si i mbërthyer në karrige. Salla ka rënë në heshtje. Konferencierja vërtitet në vend të zbulojë se ç'fshihet pas burrit që po i kullojnë djersë nëpër faqe. Jaka e këmishës së re, që i ka dërguar djali nga qyteti, i është bërë qull. Po duket sikur ai vetë nuk e ndien. E vetmja gjë që e mundon është përpjekja për të përballuar sytë e vëmendshëm të sallës. Herë pas here gjen një shteg shpëtimi, shkëputet duke u kthyer nga shoku i tij veteran, Mane Nishani. Mania rri në karrige shpenguar, sikur të jetë në dhomën e vet, dhe Mark Varfa duket se e mbledh veten. Por edhe kjo është e përkohshme. Ai ngul sytë në dysheme, lëviz dorën si të ngrirë mbi gjunjë dhe duket sikur thotë herë pas here:

«Ah, more lanet inspektor! Pse, pak veteranë ka qyteti, po vajte e më gjete mua?!»

Mark Varfa është si një minierë e thellë, e pasur, e pashtershme. Por, që të hysh në të, duhet të jesh i pregatitur. Ngado mund të hysh në botën e tij, veç jo nëpërmjet atij vetë, sepse ai do ta ndiente veten ngushtë,

nuk do të fliste fare për veten dhe ju mund të arrinit gjer atje sa të vinit në dyshim trimërinë e tij. Jua them me bindje të plotë, sepse e kam njohur nga afër dhe në mënyrë të çuditshme këtë njeri. Kam rënë një natë rastësisht në shtëpinë e tij...

Më kishte zënë nata jashtë. Mbjaj mend, ishte dimër. U ktheva prej rrugës në strehën më të parë që hasa. Pyeta ku e kishte shtëpinë Mark Varfa. I zoti i shtëpisë m'u lut të kthehesha në shtëpi të tij, se nëpër tërë atë kiamet s'kisha ku veja. Atë natë të paharruar mësova shumë prej tij për luftën e heroizmin partizan. Por unë nuk e dija se kisha shkëlur në pragun e shtëpisë së Mark Varfës. Kur e mësova, të nesërmen, u bëra me turp. «Sidoqoftë, më mirë», — mendova.

Mark Varfa tund kokën në heshtje dhe vështron nga konferencierja, sikur ta ketë vënë re për herë të parë që ndodhet atje. Vajza kthehet nga veteranët:

— Ju keni qenë të dy në një batalion gjatë luftës?

— Më të shumtën e kohës, — thotë Mane Nishani.

— Na tregoni, ju lutem, ndonjë aksion të përbashkët.

Mark Varfa shikon përpara sikur të pyesë sallën:

«Po pse, ka pasur aksione që partizanët i bënin veç, më kokë të tyre?» Pastaj kthehet nga shoku e duket sikur i thotë: «Epo, folu, o Mane!»

Mania tregon për djegie depush me municione të armikut, minime urash, dhe befas ndalet, si ta pengonte diçka e pakapërcyeshme. Mark Varfa kthen sytë përsëri nga ai.

— Kemi bërë edhe ndonjë gabim, — thotë ai. — Në luftë e sipër...

Të gjithë bëhen kureshtarë e zgjasin kokën përpara, si për të vërtetuar se mos Mania kishte dashur të thoshte diçka tjetër.

— Çfarë gabime, more! — thotë papritur Mark Varfa me zë të lartë. Unë e kuptoj se ai tani mund të rrijë e të flasë me sallën si me një mikun e vet të vjetër.

— E shikoni këtë Manen këtu? — thotë Marku dhe ngrihet më këmbë. — Këtij i thonë Mane Nishani, se nishan është! — Dhe bën dy hapa përpara si për t'iu afruar më pranë dëgjuesve. — Njëherë, i thotë komandanti i batalionit: «Pa hidhu vrojto e zbulo ç'bëhet në fshatin kundruall. Të na sjellësh lajm shpejt.» Mania erë kish qenë e furtunë u bë. Kur, pas ndonjë ore, dëgjojmë ca pushkë Hë, thamë, e vranë! U ngritëm të dëgjojmë nga binin krismat. Pas ca shohim një njeri në rripat e fshatit. «Të jetë Mania, vallë? — thamë ne. — Çne, kur vjati e u kthye! Ai sapo u nis». Kur, ç'na shohin sytë! Vjen Mania me nja dhjetë pushkë në krahë. «Ne të dërguam për lajm, jo për pushkë, Mane Nishani», — i thotë komandanti.

«Ata të Ballit, shoku komandant, s'durohen, të zgjebosurit. Ishin shtrirë në një hije, hanin e pinin. S'm'u durua, të drejtën».

«Shpëtoi njeri?» — e pyeti komandanti rreptë.

«Njëri. S'e arrita, s'di nga u fsheh».

«Të lumtë për trimërinë», i tha komandanti. Po aty për aty mblodhi batalionin. E mbaj mend si tani. Aty e dënoi ashpër dhe e shkarkoi nga detyra si skuadërkomandant.

— Po pse? — pyeti një djalë nga salla me padurim.

— Po, more djem, — tha Mark Varfa, i qetë, — rrezikohej të zbuloheshim nga armiku. Njëri kish shpëtuar dhe mund të lajmëronte...

— Po si u bë pastaj? — pyeti një tjetër nga salla.

— Partizanët nuk zihen gafil. Partizanët marrin masa, more djem, — tha Mark Varfa dhe u ul.



Unë e kuptova se atij s'i pëlqente të tregonte se kish-te qenë ai që i pat kërkuar komandantit të arrinte, të gjente ballistin e shpëtuar, pa arritur te forcat armike. Po unë e dija mirë, e kishte bërë. Ishte varur rrëzë rrëpirave, kishte ecur përrenjve, ishte ngjitur faqes së një kodre me një frymë, kishte dalë në majë dhe kishte përgjuar pas shkëmbinjve...

*Përpara shtrihej pylli i zi dhe i pafund. Çdo për-pjekje për të dalluar, goftë dhe një shenjë të vetme nje-riu, ishte e kotë. Në pyll shtigjet ishin të shumta, dhe ai kishte vendosur të zbriste përsëri përrenjve, të dilte në rrë-zë të malit, ku mbronte pylli. Po, pa arritur akoma në këmbë të malit, kishte ndërruar mendje dhe ishte kthyer e ngjitur në një kodrinë në thellësi të pyllit. Që andej kishte vrojtuar. S'ishte gabuar. Prapa, në mes të pyllit, kishte parë një shenjë të bardhë. «Qeleshja e tij» — kish-te menduar Mark Varfa. Qeleshja herë humbiste, herë shfaqej përsëri mes degëve të panumërta. Po pikërisht kur po bëhej gati të dilte përpara në shtegun nga vinte qe-leshja e bardhë, Mark Varfa kishte diktuar se ai kishte ndërruar papritur drejtimin, si një egërsirë që parandien rrezikun. «Prapa!» — kishte thënë Mark Varfa dhe qe sulur shigjetë nëpër pyll për ta arritur. Kur i ishte afruar dhe kishte njohur një nga krerët e tradhtarëve, kishte ndërruar mendje. «Jo nga krahët — kishte menduar dhe i kishte dalë përpara me armë në dorë...*

— Trimat bëjnë edhe gabime, — tha xha Varfa, — se nganjëherë e kanë gjakun të nxehtë. Si t'ua bësh fri-kacakëve, nga ata të ruhemi!

Të gjithë vështrojnë të tërhequr pas tij dhe të habi-tur që ai njeri trupshkurtër, që aty më parë e kishte të vështirë të fliste, tani dalngadalë po afrohej e po u ta-konte të gjithëve.

— Me leje, — tha një i ri, andej nga fundi i sallës, duke u ngritur në këmbë, — kemi dëgjuar se nazistët kanë ardhur në krahinën tonë me forca të mëdha. Bashkë me ta këtu ka lënë kockat edhe nipi i njërit prej bashkëpunëtorëve më të afërt të Hitlerit... Mund të na tregoni gjë?...

— Po, këtu është vrrarë... — kaq tha dhe heshti.

— Xha Varfa, kemi marrë vesh se gjatë luftës të gjithë shokët ju thërrisnin «Kuço».

— Është e vërtetë, moj bijë, sepse atëherë kisha flokë dhe fytyrë si më të kuqe. Po tani, siç e shihni, jam zbardhur nga pleqëria.

— Thërrisnin njeri tjetër «Kuço» në batalion? — e pyeti ajo përsëri.

Mark Varfa nuk e nuhati dot në fillim dinakërinë e vajzës.

— Jo! — tha ai.

— Domethënë s'kishit! — përsëriti vajza në mënyrë triumfuese. — Ne kemi marrë vesh se nipin e bashkëpunëtorit të Hitlerit e ka vrrarë një «kuço», xha Varfa, — i tha vajza, e kënaqur, që më në fund kishte mundur t'i shkëpuste plakut të urtë e të thjeshtë përgjigjen e vërtetë...

Mark Varfa, i emocionuar, shkoi dorën nëpër flokët e bardhë. Salla u duk sikur u avit akoma më tepër nga ai. Ai rrinte para tyre si i zënë në faj. Nxori shaminë të fshinte djersët, por po e mbante kot në duart e rreshkura. Qëndroi një hop i menduar, me kokën gjysmë të ulur. Plaku e ndjeu se sytë e të gjithëve ishin mbërthyer tek ai dhe drejtoi trupin, duke i përpjekur të zotëronte sallën. Po vështrimi i mbeti në radhët e para, si i hutuar. Pastaj, dy pika lot nisën t'i rridhnin nëpër faqe...

— Kisha një shok të shtrenjtë, — tha i ngashëryer.